



Prishtinë, 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_091\_2008

Bordi i Zyrës së rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080”;
2. Dispozitat e Nenit 7 të Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore;
3. Kërkesën me shkrim të N.Q Gjakova SH.A të dërguar në ZRRE me datë 10 prill 2008, në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2008, nxori këtë:

## VENDIM

**I. APROVOHET** kërkesa e N.Q “Gjakova” për emërimin e ekspertit të pavarur.

1. Sipas Nenit 7 licencës së Gjenerimit të N.Q “Gjakova” ka për obligim të caktojë një ekspert të pavarur, emërimin e të cilit do ta aprovojë ZRRE-ja.
2. Me 10 prill 2008 N.Q “Gjakova” ka kërkuar nga ZRRE të aprovojë kërkesën për emërimin e **Z. Ruzhdi Canhasi, inxh. i dipl. i makinerisë** si ekspert i pavarur.
3. ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e N.Q “Gjakova” dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatit ka aprovuar kërkesën që **z. Ruzhdi Canhasi inxhi. i dipl. i makinerisë** të jetë ekspert i pavarur i cili, në bazë vjetore, do të kryej kontrollin teknik dhe të sigurisë së njësisë gjeneruese N.Q “Gjakova”.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bashkëngjitur: Biografia e Z. Ruzhdi Canhasi

Bordi i ZRRE-së:

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Nysret Avdiu, Anëtar